

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët Have Haliti Kryetare, Fillim Skoro, gjyqtar referues e Tonka Berishaj anëtare me bashkëpunëtorin profesional Sadik Kryeziu, si procesmbajtës në çështjen penale të akuzuarit A.XH.K., nga ..., Republika e Shqipërisë, për veprën penale në bashkë kryerje blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope analoge, nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPPK-së, për te vendosur sipas ankesave të PTH-DKR në Pejë, të mbrojtësit të akuzuarit av. M.H. dhe përgjigjes në ankesë të mbrojtëses së të akuzuarit, av.A.K., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, PRK/P.nr.69/2018 të dt.26.10.2018, në seancën publike të kolegjit me dt.18.12.2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohen ankesat e PTH-DKR në Pejë dhe mbrojtësit të akuzuarit A.K., av.M.H., si të pa bazuara dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, PRK/P.nr.69/2018 të dt.26.10.2018, vërtetohet.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, PRK/P.nr.69/2018, të dt.26.10.2018, i akuzuari A.K., nga ..., Republika e Shqipërisë, është shpallur fajtorë për veprën penale në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPPK-së, dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4(katër)viteve, duke ja llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga dt.23.03.2018, e tutje, e deri në përfundim të dënimit të shqiptuar si dhe me dënim me gjobë në shumë prej 2000(dymijë)Euro, të cilin i akuzuari është obliguar që ta paguajë në afatin prej 3(tre)muajve, pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit me kërcënimin e shndërrimit në dënim burgu konform nenit 46.3 të KPK.

Të akuzuarit A.K., i është vazhduar masa e paraburgimit konform nenit 367 pika1.1 të KPPK-së, për shkak se gjykata konsideron se ende ekzistojnë arsyet ligjore për të cilat është caktuar ngas i akuzuari është shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe se nuk ka vendbanim të caktuar në territorin e Republikës së Kosovës.

Të akuzuarit A.K., i është shqiptuar dënimi plotësues konfiskimi i substancës narkotike e llojit kanabis(hashish), në peshë të përgjithshme prej 49 kg. E 1.41,49 gr. Të shënuar sipas ekspertizës konformë nenit 273 par.5 të KPK, të cilat urdhërohen që të shkatërrohen në bazë të nenit 10b të referencës administrative 2004/5, sipas rastit të polici 2018-YËK-02, të dt.23.03.2018.

Të akuzuarit i është konfiskuar edhe automjeti i markës "Daimler-Chrysler", me ngjyrë të zezë, me targa "XX – YZ" dhe me shënimet tjera si në shkresat e lëndës, konform nenit 273 par.5 të KPK, si mjete për kryerjen e veprës penale, gjithashtu të akuzuarit i është konfiskuar shuma e parave në vlerë prej 420 (katërqindnjëzet)Euro, të cilat urdhërohen që te kalojnë.

I akuzuari A.K., është obliguar të paguajë shpenzimet gjyqësore në lartësi prej 50Euro, si dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 50Euro, e po ashtu edhe taksën shtesë në fondin për mbrojtjen e viktimave në lartësi prej 50Euro, gjithsejtë 150Euro, që të gjitha në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, konformë nenit 453 par.1 të KPPK-së.

Ndaj të pandehurit A.P., nga ..., Republika e Shqipërisë, është refuzuar akuza konformë nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPK, për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psiko-trope dhe analoge nga neni 273 par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK, ngase prokurori është tërheq nga aktakuza.

Të pandehurit A.P., i është ndërprerë masa e paraburgimi me dt.23.10.2018, për shkak se me këtë aktgjykim janë ndërprerë edhe arsyet ligjore për të cilat paraburgimi ishte caktuar, ndërsa shpenzimet e procedurës gjyqësore bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë kanë parashtruar ankesa:

-Prokuroria Themelore-DKR në Pejë, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit A.K., ti shqiptohet një dënim më i lartë me burgim e me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit.

-Mbrojtësi i të akuzuarit A.K., av.M.H., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit,

-Përgjigje në ankesë ka paraqitur mbrojtësja e të pandehurit A.K., av.A.K., me propozim që Gjykata e Apelit, ta refuzoj ankesën e PTH-DKR në Pejë, si të pabazuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të pandehurit, t'ia zbusë dënimin e shqiptuar në pajtim me dispozitat ligjore.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.535/2018, të datës 29.11.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e PTH-DKR në Pejë, dhe të mbrojtësit të pandehurit av.M.H., ka propozuar që ankesa e PTH-DKR në Pejë të aprovohet si e bazuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i lartë me burg efektiv se sa me aktgjykimin e ankimuar, ndërsa të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.K., av.M.H., dhe përgjigjja në ankesën e PTH-DKR në Pejë, e parashtruar nga mbrojtësja A.K..

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPP të Kosovës, ka caktuar seancën e kolegjit, në të cilën morën pjesë i akuzuari A.K. dhe mbrojtësit e tij, av.M.H. dhe av.A.K., ndërsa nuk prezantoi askush nga Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, edhe pse ishin njoftuar në mënyrë të rregullt dhe seanca është mbajtur në mungesë të tij, në pajtim me dispozitën e nenit 390 par.4 të KPP.

Gjykata e Apelit në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KP të Kosovës, vlerësoi ankesën e PTH-DKR në Pejë, të mbrojtësit të akuzuarit av.M.H. dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtëses së të

akuzuarit, av.A.K., si dhe të sqarimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit, shqyrtoi dhe vlerësoi shkresat e lëndës, dhe gjeti:

Ankesat e PTH-DKR në Pejë dhe e mbrojtësit të akuzuarit A.K., refuzohen si të pabazuara.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Themelore-DKR në Pejë, në ankesën e saj pretendon se është e mendimit se gjykata me rastin e vendosjes së vendimit ka mbi vlerësuar rrethanat lehtësuese, ndërsa nuk janë vlerësuar në masë të duhur rrethanat rënduese, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.K., av.M.H., në ankesën e tij, pretendon se me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin nuk janë zbatuar dispozitat e KPRK-së, me rastin e marrjes së dënimin edhe pse gjykata ka cekur nenin 75 të KPRK-së me marrjen e vendimit mbi dënimin, ajo dënimin e ka shqiptuar mbi minimumin ligjor. Gjykata si rrethanë rënduese ka vlerësuar shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, posaçërisht llojin dhe sasinë dhe shkallën e përgjegjësisë penale, e të cilat rrethana janë përfshirë në vet dispozitën ligjore, për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari. Edhe sa i përket sasisë gjykata vënë në kundërshtim me ekspertizën e AFK-së, nga e cila ekspertizë rezulton se substanca narkotike mund të jetë hashash, që në fakt është më e lehtë se kanabisi. Gjykata ka vlerësuar rrethanat lehtësuese, pranimin e fajit, sjelljen dhe qëndrimin pendues të akuzuarit, padënueshmerinë, moshën relativisht të re dhe gjendjen ekonomike. Sipas ankesës rrethana e pranimit të fajësisë, duhet të vlerësohet si rrethanë posaçërisht lehtësuese, përveç rrethanave të cilat i ka vlerësuar gjykata e mbi të cilën do të mund të merrej vendimi më i favorshëm për të akuzuarin, janë edhe se i akuzuari nuk është në marrëdhënie pune, statusin shëndetësor i motrës së tij të vetme, e cila vuan nga një sëmundje e rëndë, premtimi se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin dhe padënueshmëria e tij.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e PTH-DKR në Pejë, dhe të mbrojtësit të akuzuarit, e sipas detyrës zyrtare, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit.

Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit konstaton se aktgjykimi i ankimuar, është përfshirë në shkeljet e ligjit penal, nga neni 385 par.1 nën. par 1.4, në dobi të akuzuarit A.K., për arsye se Prokurori i shtetit me ngritjen e aktakuzës kundër të pandehurit A.K., ka zbatuar ligjin i cili nuk mund të zbatohet nga neni 385 par 1 nën par 1.4 të KPP, dhe nga përshkrimi faktik i dispozitivit të aktgjykimit dhe nga provat të cilat ekzistojnë në shkresat e lëndës rezultojnë se i akuzuari ka eksportuar kanabis(hashish), në peshë prej 49 kg e 141,49gr. e cila substance narkotike është gjetur te i akuzuari në automjetin e tij të markës “Daimler-Chrysler”, i cili ka kaluar përmes vend kalimit kufitar Shqipëri- Kosove me dt.23.03.2018, dhe në pikën kufitare në Kullë për të shkuar në Mal të Zi është gjetur substanca narkotike e cekur me lartë, në automjetin e tij të markës “Daimler-Chrysler”, dhe nga kjo jep të kuptohet, se nuk kemi të bëjmë me transport, dhe sipas Gjykatës së Apelit, për të ekzistuar transporti, si një nga elementet e veprës penale, ajo transportohet prej një vendi në një vend të caktuar, prej qyteti në qytet, ndërsa në këtë çështje penale kemi të bëjmë me eksport, për arsye se narkotiku i cekur më lartë është eksportuar dhe ka kaluar kufirin Shqipëri – Kosove, dhe te i akuzuari sasia e narkotikut në peshë prej 49 kg. e 141,49 gr. është gjetur në automjetin e tij të

markës “Daimler-Chrysler” në piken kufitare në Kullë , e nga kjo dele se nuk kemi te bëjmë me veprën penale nga neni 273 par 2, të KPRK –së, por kemi te bëjmë me veprën penale nga neni 273 par.3 të KPRK –së dhe në veprimet e të akuzuarit formohen elementet e eksportit dhe importit, e jo të transportit, duke marr parasysh edhe sasinë e cekur më lartë, atëherë rezulton se kemi te bëjmë me veprën penale nga neni 273 par.3 lidhur me nenin 281 par.1 nën par 1.9 të KPRK-së, e nga kjo del se është shkel ligji penal ne dobi te akuzuarit me rastin e ngritjes se aktakuzës, nga prokuroria e shtetit, e të cilën shkelje vetëm e konstaton Gjykata e Apelit, ndërsa aktgjykimin nuk e ka anuluar për arsye se aktakuza ka marrë formën e prerë dhe e njëjta më nuk mund të ndryshohet.

Pretendimet ankimore të PTH-DKR në Pejë, se vendimi mbi dënimin është i butë, dhe të ankesës së mbrojtësit të akuzuarit A.K., se dënimi i shqiptuar është i ashpër, janë pretendime ankimore të pabazuara. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, PTH-DKR në Pejë, në ankesën e saj nuk cekë asnjë rrethanë që kishte me ndikuar në ashpërsimin e dënimit, vetëm jep një konstatim dhe sipas prokurorisë ajo mendon se dënimi duhet të ashpërsohet dhe gjykata i ka mbi vlerësuar rrethanat lehtësuese, ndërsa në ankesë nuk ceket asnjë rrethanë rënduese apo posaçërisht rënduese e që kishte me ndikuar në kuptim të dispozitave ligjore që dënimi të ashpërsohet. Sa i përket ankesës së mbrojtësit të akuzuarit Gjykata e Apelit, vlerëson se edhe ajo është e pabazuara për faktin se gjykata i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese të cilat janë cekur edhe në ankesë, pranimin e fajësisë, sjelljen e të akuzuarit dhe qëndrimin pendues të tij, se më parë nuk ka qenë i dënuar dhe se i akuzuari është i moshës relativisht të re si dhe rrethanat e vështira ekonomike në të cilat ai jeton, e të cilat rrethana si të vërtetuara i aprovon edhe Gjykata e Apelit, dhe dënimi i shqiptuar me gjobë në shumë prej 2.000(dymijë)Euro dhe dënimi me burgim i shqiptuar në kohëzgjatje prej 4(katër)vite, në të cilin dënim i është llogaritur, edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.23.03.2018 e tutje, këto dënime komulative të shqiptuara janë marrë në bazë të rregullave të përgjithshme mbi matjen e dënimit, të paraparë si në nenin 73 të KPRK, dhe dënimi i shqiptuar komulativ me gjobë dhe me burgim, është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale, dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe me këto dy dënime komulative të shqiptuara te i akuzuari,dënimi i shqiptuar komulativ te i akuzuari duhet të ndikoj pozitivisht që në të ardhmen të mos kryej vepra të këtilla apo të ngjashme, e njëkohësisht dënimi i shqiptuar të ndikoj edhe te të tjerët në parandalimin e veprave penale të këtilla, dhe pritet që të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë si në nenin 41 të KPRK.

Si u cekë edhe më lartë, u deshtë që ankesat e PTH-DKR në Pejë dhe e mbrojtësit të akuzuarit, të refuzohen si të pabazuara, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, e në bazë të nenit 401 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.565/2018, me dt.18.12.2018

Procesmbajtësi,

Sadik Kryeziu

Anëtarët e kolegjit,

Fillim Skoro

Tonka Berishaj

Kryetare e kolegjit,

Have Haliti